



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 640 Prot.

Tiranë, më datë 13 . 12 .2024

VENDIM
Nr. 538, datë 13.12.2024

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhërit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 13.12.2024:

VENDOSI

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për Raportin e vëzhgimit arkeologjik sipërfaqësor hartuar në kuadër të projekti “Hotel 3 kat mbi tokë, 4 kat nën tokë + pishinë”, Ksamil, Bashkia Sarandë, me zhvillues subjekti “Epidamn C” sh.p.k., me argumentin;
 - Të plotësohet aplikimi me Raportin e ndikimit në trashëgimi kulturore (HIA) në gjuhën shqipe dhe angleze;
 - Raporti të përcillet nga IKTK për mendim në UNESCO;
 2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi;
 3. Kundër këtij vendimi mund të ushtrohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Sokol ISMAILI

KRYETAR
Blendi GONXHJA

